

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegj i përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Emine Kaçiku, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, kundër të paditurës NN “W” me seli në Shkabaj – Prishtinë, për shkak të pagesës së borxhit në shumë prej 12.586,73 €, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ae.nr.136/2015 datë 14.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 8.3.2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ae.nr.136/2015 datë 14.10.2016.

Pranohet si i bazuar revizioni i të paditurës vetëm sa i përket vendimit lidhur me kamatën e gjykuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.710/2014 datë 30.4.2015, kështu që ky aktgjykim si dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ae.nr.136/2015 datë 14.10.2016, në këtë pjesë ndryshohen, ashtu që e paditura detyrohet që shumën e gjykuar prej 12.586,73 €, paditëses t’ia paguaj me kamatë të cilën e paguajnë bankat vendore si për deponimet në kursim me afat mbi një vit e pa destinim të përcaktuar, duke filluar nga data 23.4.2015, si ditë e paraqitjes së padisë e gjer në përmbushjen definitive të borxhit.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ae.nr.136/2015 datë 14.10.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.710/2014 datë 30.4.2015, me të cilin është aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses dhe është detyruar e paditura që paditëses, në emër të borxhit t’ia paguaj shumën prej 12.586,73 €, me kamatë ligjore prej 3,5%,

duke filluar nga data 23.4.2015 si ditë e paraqitjes së padisë e gjer në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbasimit të dhunshëm. Për shpenzimet e procedurës është vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të prishen të dy aktgjykimet e lartpërmendura dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për procedurë kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion dhe gjeti se:

Revizioni i të paditurës është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 23.4.2010, paditësja ka paraqitur padi në gjykatën e shkallës së parë me të cilën ka kërkuar që në emër të borxhit, e paditura t'i paguaj shumën prej 12.586,73 €, i cili borxh rezulton nga fakti se e paditura pa lejen e punëdhënësit ka ndryshuar projektin për ndërtimin e fazës së parë të palestrës sportive në Rahovec, ashtu që punët janë zvogëluar në vlerë prej 12.586,73€. Nuk është kontestues fakti se e paditura ka ndryshuar projektin e ndërtimit të fazës së parë të kësaj palestre sportive, dhe atë pa marrë pëlqimin e punëdhënësit, respektivisht pa ndonjë aneks kontrate të nënshkruar mes palëve kontraktuese. Nuk është kontestues në mes palëve edhe fakti se në mes tyre ka ekzistuar kontratë e nënshkruar nga palët kontraktuese për ndërtimin e fazës së parë dhe të dytë të palestrës sportive në Rahovec në vlerë prej 332,825.26 €, të cilën shumë e paditura e ka pranuar nga paditësja, ndërsa në fakt vlera e punëve të kryera është 320.238.53 €, kështu që e paditura nga paditësja ka marrë më tepër se sa vlera e punimeve të bëra në favor të paditëses, në shumën prej 12.586,73 €.

Në një gjendje faktike të vërtetuar kësi soji, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar në bazë të nenit 633 të LMD-së, andaj ka vendosur në tërësi si në dispozitivin e aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të së njëjtës gjykatë.

Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë lidhur me pranimin si të bazuar të kërkesëpadiës së paditëses, kjo ngase

aktgjykimet e këtyre gjykatave nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Objekt shqyrtimi në gjykatën e revizionit ishin pretendimet e revizionit përkitazi me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, të cilat sipas të paditurës qëndrojnë në atë se me paditësen është arritur marrëveshja gojore për përshtatje të projektit pa bërë ndryshimin esencial të tij, me çka është shkelur neni 645 dhe neni 649 i LMD-së, se ky ndryshim i planit nuk është bërë nga ana e të paditurës në mënyrë të njëanshme, dhe se organi mbikëqyrës i paditëses ka bërë mbikëqyrjen e punëve të kryera të cilat janë pranuar pa vërejtje. Këto pretendime të revizionit, të paraqitura edhe më parë, dhe të vlerësuara nga të dy gjykatat e lartpërmendura, edhe gjykata e revizionit nuk i pranon si të bazuara, ngase sipas nenit 633 par. 1 të LMD-së, për çdo largim nga projekti i ndërtimeve, respektivisht nga punimet e kontraktuara, zbatuesi duhet të ketë pëlqimin shkresor të porositesit. Sipas par. 2 të këtij neni, ai nuk mund të kërkojë asnjë ngritje të shpërblimit të kontraktuar që i ka kryer pa pëlqimin e këtillë. Dispozitat e nenit 645 dhe 649 të LMD në të cilat e paditura thirret në revizion, nuk kanë të bëjnë me çështjen kontestuese, respektivisht kërkesën e paditëses për pagesën e këtij borxhi. Përndryshe, edhe gjykata e revizionit vlerëson se për shumën kontestuese e paditura nuk ka kryer punë për paditësen, andaj për të njëjtën shumë është pasuruar pa bazë juridike, kështu që është e detyruar që të njëjtën shumë paditëses t'ia kthejë.

Për arsyet e paraqitura më lartë revizioni i të paditurës sa i përket borxhit kryesor u refuzua si i pabazuar, mirëpo sa i përket vendimit mbi kamatën revizioni i të paditurës u pranua si i bazuar për faktin se lartësia e kamatës së aprovuar prej 3.5% është në kundërshtim me nenin 277 të LMD-së, kështu që në pajtim me këtë dispozitë ligjore përkitazi me kamatën aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë u ndryshua në tërësi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë, në pajtim me nenin 222 dhe 224.1 të LPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

E.Rev.1/2017, datë 8.3.2017

Kryetari i kolegjit,

Shukri Sylejmani